FOTAQ ANDREA

Stradiotët shqiptarë, kontribut historik me vlerë për Europën perëndimore

Ashtu sikurse për kapelen historike shqiptare të quajtur albanua, historiografia shqiptare ka qenë, të themi, disi e kufizuar lidhur me temën e stradiotëve shqiptarë. Megjithatë, duhet pranuar se kohët e fundit tema është rrahur tërthorazi nga një numër studjuesish shqiptarë, ndër të tjerë nga At Zef Valentini, Irakli Koçollari, Aristidh Kolja, Moikom Zeqo, Ferid Hudhri etj[*]. Në këtë studim, veç autorëve të sipërpërmendur, do të përqendrohemi kryesisht tek autorë të huaj, veçanërisht francezë, për të dhënë një tablo disi më të plotësuar të stradiotëve shqiptarë, ndonëse tema është e gjerë dhe i tejkalon caqet e këtij studimi.

Duhet thënë që në fillim se dukuria stradiote apo estradiote shqiptare (*estradiots albanois*), e vështruar në kontekstin historik, ashtu sikurse dukuria e kapeles albanua, nuk është një rastësi. Ajo duhet parë mbi të gjitha brenda kushteve të caktuara historiko-ekonomiko-shoqërore si dhe e lidhur ngushtë me vetë natyrën apo karakterin e shqiptarit, me organizimin e tij fisnor, me cilësitë dhe të drejtat juridike që shpjegojnë në thelbin e tyre vetë këtë dukuri. Le t'i shohim me radhë këto çështje :

Së pari, dukuria e stradiotëve shqiptarë është shfaqur në fillim të shekullit XI si pasojë e kërcënimit të huaj, kur shqiptarët (albanensis), përballë sulmeve të normanëve, serbëve, bullgarëve, venecianëve, katalanasve, etj., u detyruan të zbresin në mënyrë masive drejt Jugut, në territoret e Greqisë kontinentale dhe asaj ishullore. Në këto kushte, Perandoria Bizantine në dobësim e sipër, mori masa për të fuqizuar makinën e saj ushtarake duke ngritur vendbanime të reja apo koloni ushtarake që u quajtën "stratopia". Banorët e këtyre kolonive, apo të vendbanimeve ushtarake në Greqi (*stratopiat*) ishin "të formuara krejtësisht me banorë të ardhur nga trojet e Arbërisë", "të përzgjedhur me kritere dhe synime të qarta", për "përgatitje dhe aftësi luftarake", duke u quajtur me termin grek stratiotë".[1]

Është pikërisht krijimi i *stratopive* me stradiotë shqiptarë që shpjegon jo vetëm masat e marra nga Perandoria Bizantine për fuqizimin e saj, por edhe ngulimin në mënyrë paqësore të fiseve shqiptare në mes të popullsive autoktone greke[2], duke u shfaqur kësisoj si një "faktor nxitës për progres e zhvillim cilësor" të vetë Greqisë, sikuse do ndodhë edhe në raste të tjera analoge historike të mëpasshme. Banorët e stratopive jo vetëm mbushnin radhët e njësive të luftës, por fitonin edhe privilegjin e marrjes në pronësi të tokës, privilegj që, në fakt, nuk e gëzonte popullsia e zakontë, e cila detyrohej të punonte argate në tokat e feudalëve vendas.

Studjuesi bashkëkohor Edwin Jacques, duke cituar historianin bizantin Kanteku vë në dukej se në periudhën 1202-1204 grindjet midis fisnikëve bizantinë dhe princëve latinë pas Kryqëzatës së Katërt e kishin shkretuar fshatin grek. "Arvanitët apo shqiptarët e sapoardhur, thotë ai, u vendosën në toka djerrë, prenë pyjet dhe hapën toka të reja të punueshme. Falë punës së këtyre bujqëve me përvojë u lëruan dhe u mbollën me drithra të ndryshme. Këta

---

[*] Po ashtu, Prof. Pëllumb Xhufi ka përkthyer e botuar kohët e fundit veprën e mirënjohur të studiuesit italian Paolo Petta, "Stradiotët – Ushtarë shqiptarë në Itali në shekujt XV-XIX."

[1] I. Koçollari, "Arvanitët", Albin, Tiranë, 1994, f. 36, 38.

[2] George Guillet do të nënvizonte në këtë drejtim : "Sidoqoftë, nga tërë popujt e Greqisë, ndodhi që vetëm epirotët, të quajtur sot albanoi, dhe maniakët [maniotët], mbetje e mjerë e lakedemonasve, mundën të pengojnë përparimin e turqve. Albanoiët u thyen në vitin 1466 kur vdiq i famshmi Skanderbeg, princi i tyre i pamposhtur; dhe në përhapjen që u bë atëherë të subjekteve dhe trupave të tij, një pjesë e mirë u tërhoq midis maniotëve, të cilët i pritën me gëzim dhe u dhanë banesa në malet e tyre të thepisura. Për fe, ruajnë ende atë të grekëve të tjerë. Dhe kanë midis tyre shumë kallogjerë". (Sipas librit : "Athènes ancienne et nouvelle", Paris, 1657, f. 32-33).

shqiptarë nuk erdhën si pushtues, por si refugjatë, të cilët do të jetonin e punonin për përparimin e Greqisë dhe do të jepnin jetën e tyre për pavarësinë e saj nga Turqia".[3]

Lidhur me zanafillën shqiptare të stratopive, studjuesi A. Koçollari citon një letër të perandorit bizantin M.Paleologu të fundit të shekullit XII drejtuar vëllait të tij Theodhorit, princ i Moresë, në të cilën vihet në dukje, si një nga sukseset më të mëdha, vendosja e arvanitëve (shqiptarëve) në principatën e Moresë : "...Me këtë ushtri (shqiptarësh) – thekson perandori Paleologu -, që kurrë nuk ka parë disfata, por në të kundërt janë dalluar si shumë të aftë dhe të suksesshëm për luftë, nuk është shpenzuar asgjë, veç janë dhuruar impresione të shkëlqyera kudo... Duke ardhur ti me këtë ushtri në Peloponez (i drejtohet ai princit Theodhor), ushtri që nuk është e vogël, por mjaft e madhe dhe e fuqishme, shumë e zhdërvjelltë dhe e aftë, rregulluam gjithçka që mundëm dhe që na lypsej"[4]. Po në këtë periudhë daton edhe një dokument i vitit 1295, i sevastokrati të Fanarit (Thesali) dërguar hierarkëve të tij, në të cilën bëhet fjalë për vendosjen e shqiptarëve në viset greke në bazë të akteve ligjore dhe urdhëresave perandorake. "... Nuk do të lejoj, thuhet në të, të vijnë më këtu shqiptarë veç atyre të vendosur me trashëgimi trojesh në zonat rreth kështjellave (të Fanarit) apo atyre që janë vendosur aty mbi bazën e kristobulave dhe urdhërave perandorake..."[5]

Duke u mbështetur tek orientalisti i mirënjohur N. Sathas, At Zef Valentini, nga ana e tij, vë në dukje se në fillim të shekullit XI, shfaqen si stradiotë katër anëtarë të dinastisë së shquar ushtarake Bashta (Basta), nga gjiri i së cilës vijuan të dalin ushtarakë me emër.

Një dëshmi tjetër për këtë periudhë të shfaqjes së stradiotëve na sjell edhe francezi Andre Grasset-Saint Sauveur i Riu, kur flet për inkursione të albanoive në shtetet e Napolit në vitet 1258-1309. Filipi, vëllai i Karlit marshon për t'i ndalur. "Albanoiët përfituan nga rasti kur Karli ishte i zënë në drejtim të Siçilisë, për të bërë inkursione të shpeshta në provincat e shteteve të tij. Filipi, princ i Tarentes, vëlla i mbretit të Napolit, marshon për të ndalur progresin e tyre... përparoi kundër albanoive që i komandonte njëfarë Spatafori. I sulmoi në befasi, i shpërbëu dhe depërtoi më në thellësi në Greqi" Dhe vijon më tej : "Teksa Roberi, për të cilët korfiotët ishin të lumtur nën qeverimin e tij, do të vdiste..., po në atë kohë, Bajazeti, sovran i tuqve sapo kishte rrënuar e dëbuar të atin e Depanit, prijës i albanoive, i cili u strehua në Korfuz, ku u mirëprit dhe qëndroi gjersa vetë Bajaziti ra edhe ai nën përpjekjet e Timurlengut"[6].

Ndërkohë, vërejmë se kalorës shqiptarë vihen në shërbim të Venedikut në shekujt XII-XIII me misione të posaçme për ruajtjen e rendit në zotërimet venedikase. Dëshmojnë në këtë drejtim dokumentet venedikase, madje një dekret i Senatit kërkon "të nxitet sa më shumë tek ishullorët shitja e armëve për ruajtjen e rendit në ishull. Guvernatorët e Pargës, Butrintit dhe Bastias morën urdhër të formonin një trupë ushtarësh të nxjerrë nga ishulli [Korfuzi] dhe të vënë në shërbim të republikës. Shmangeshin kështu trupat mercenare nga Shqipëria, për të cilat i vetmi synim ishte interesi".[7] Një dëshmi interesante kemi edhe në shënimin e një urdhërese lëshuar nga mbreti në Nikozi të Qipros për ruajtjen e vaut të Kaputit më 1468, kur thuhet se venedikasit, që nga koha e Luzinjanëve, mbanin për ruajtje të ishullit një trupë stradiotësh shqiptarë me mision të posaçëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e brigjeve.[8]

---

[3] Edwin Jacques, "Shqiptarët", Tiranë 1995, f. 220.

[4] Kostas I. Biris, "Arvanites , i dori tu neoteru elenizmu", Athina 1967; Irakli Koçollari, vep. e cituar, f. 39.

[5] Po aty.

[6] André Grasset-Saint Sauveur i riu, Konsull i Republikës franceze në Levant, "Voyage historique, littéraire… des îles de la république française dans le Levant », Paris 1798, f. 257-258, 283-284.

[7] Po aty, f. 484.

[8] M.L.de Mas Latrie, "Histoire de l'île de Chypres", Paris 1855, f. 238, 464-465. Në shënim thuhet : "Albanojët ishin mbi një mijë në numër dhe i binin me kalë kryq e tërthor tërë brigjeve, në grupe dy nga dy dhe kështu bënin përgjimin. Nëse zbulonin diçka (ardhje të anijeve pirate), ndiznin zjarre për dhënie alarmi. Flitet në Ishull për një "societas ad stradiotum", një shoqëri apo milici e ndërtuar sipas mënyrës stradiote. Venedikasit kishin në tërë zotërimet e tyre lindore, dhe sidomos në More, shqiptarë me kuaj, armatosur me mburojë, heshtë e shpatë, që merrnin një pagesë nga republika për mbrojtjen e vendit. *Këta kalorës vetëquheshin stradiotë, emër me të cilin përcaktoheshin kalorësit në Shqipëri*

Konti Artur de Gobineau, i cili ka folur mjaft dhe me simpati për shqiptarët dhe etninë e tyre të lashtë, do të vinte në dukje : "Të gjitha ushtritë i njohin dhe i përdorin [stradiotët]. Në shekullin XII, gjermanët, francezët, spanjollët, Papa, fjorentinasit, duka i Milanos i kanë pasur në shërbim të tyre. Sinjoria Venedikase rekrutonte stradiotë në shekullin XIII dhe anglezët e Shtatë Ishullorëve i kanë ende në shërbim të tyre në ditët tona. Edhe pse Bayard vlerësonte më së miri kapiteni Merkurio dhe shqiptarët e tij, pavarësisht që nuk pranonte në çdo rast ashpërsinë dhe shpegimin e metodave që përdornin, kompanitë e kalorësisë së lehtë u mbushën plot me njerëz të tillë dhe disa nga këta zanatllinj të luftës u vendosën në Francë, prej të cilëve dolën njerëz të ndershëm. Por shumica, pas fushatash të gjata në kohë, ktheheshin në vatrat e tyre, në Epir, Thesali, Maqedoni, More..."[9]

Së dyti, faza e lulëzimit të plotë të estradiotisë shqiptare është periudha para, gjatë dhe pas lulëzimit të shtetit shqiptar të Arbërit nën drejtimin e Gjergj Kastriotit, në vitet 1400-1600, pra mbi dy shekuj lulëzim të stradiotëve shqiptarë, që do të shfaqeshin si flamurtarët dhe veprimtarët kryesorë të kalorësisë së lehtë europiane, "manifestin" e parë teorik të së cilës do ta hartonte, siç do të shohim më pas, po një shqiptar, gjeneralissimi Gjergj Basta.

Lindja dhe zhvillimi i estradiotisë shqiptare u realizua, sikurse e vë mirë në dukje At Valentini, mbi bazën e tipareve juridike të fisit në bashkësitë shqiptare, të cilësive që e karakterizonin si një "individualitet i përsosur", me të drejtën për të pasur një gradë të caktuar autonomie dhe forcat e veta të armatosura; po ashtu, me të drejtën e katundit për të bërë aleanca, luftra e për të lidhur pakte me të tjerë, me të drejtën për të bërë politikë të jashtme dhe më në fund, me të drejtën për të pasur prirësin apo prirësit e vet.

Analiza e At Valentinit për tiparet juridike të fisit në bashkësitë shqiptare, për cilësitë dhe të drejtat e tyre të karakterit ushtarak nga njëra anë, dhe për shpërnguljen e tyre sipas boshtit Veri-Jug (Shqipëri-Greqi), nga ana tjetër, mbështet katërcipërisht konkluzionin e studjuesit Koçollari se vendbanimet ushtarake në Greqi (stratopiat), sikurse e theksuam edhe më lart, ishin "të formuara krejtësisht me banorë të ardhur nga trojet e Arbërisë". Madje, ngulmon studjuesi Koçollari, këto vendbanime "u thirrën e thirren edhe sot e kësaj dite në gjuhën e tyre "katun".[10] Banorët e stratopive jo vetëm mbushnin radhët e njësive të luftës, por fitonin edhe privilegjin e marrjes në pronësi të tokës, privilegj që, në fakt, nuk e gëzonte popullsia e zakontë, e cila detyrohej të punonte argate në tokat e feudalëve vendas.

Mbi bazën e këtyre dukurive e karakteristikave, si dhe të të dhënave toponomastike që parashtron At Valentini, kuptojmë shpërnguljen kolektive të familjeve të mëdha stradiote shqiptare, që gjeografikisht kanë ndjekur boshtin lëvizës Veri-Jug, dhe tepër rrallë Jug-Veri. Më pas, nga Jugu i Shqipërisë, kjo lëvizje ka vazhduar gjer në Greqi, e që këtej bien në sy shpërnguljet e mëdha historike të fiseve shqiptare, të cilat merrnin drejtimin e Italisë, qoftë në Jug (Siçili, Kalabri, Napoli), qoftë në Veri (kryesisht në zonën venete dhe lombarde).

Mbështetur në toponomastikë, por edhe në emrat e përveçëm të stradiotëve (ku bie dukshëm në sy emri Gjin, për shembull), At Valentini thekson se shpesh mbiemri stradiot njeh rotacion sa gegë dhe toskë, gjithnjë në bazë të boshtit lëvizës e shpërngulës të fiseve shqiptare Veri-Jug, Jug-Greqi, Veri-Itali dhe Greqi-Itali. Kuptohet që më pas, nga Italia, skuadronet stradiote shqiptare do merrnin udhë drejt Spanjës, Francës, Belgjikës, Hollandës, Austrisë e më tej. Toponimet e të njëjtit mbiemër fisnor ndeshen sa në Veri (Mat e Lurë), aq edhe në Shqipëri të Mesme – si për shembull mbiemri Buziki apo Buzhuqi. Mbiemri Dara ndeshet sa në Rrjoll, aq edhe në Itali e Greqi (Arkadi); mbiemri Dorëza (shoqëruar me emrin Gjin) ndeshet sa në Pezë, Peqin, Skrapar, Çermenikë, Tepelenë, aq edhe në Itali, Greqi (Arkadi, Qefaloni). Më tipiku këtu është mbiemri shqiptar Jonima, përhapur gjerësisht në toponomastikën Veri-Jug (Rrjoll, Gruemirë, Grizhë, Dajç, Lurë, Kurbin, Durrës, Elbasan, Dukat për ta hasur historikisht gjer në Napoli të Italisë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për mbiemrin Kelmendi, mjaft i përhapur ndër stradiotët shqiptarë që përmendin autorët e huaj,

---

(nënvizimi ynë). Ishin të organizuar në kompani dhe shpesh futeshin në radhët e tyre edhe qytetarë nga vendi ku ndodheshin.

[9] A.de Gobineau, "Deux études sur la Grèce moderne", Paris 1905, f. 98.

[10] Irakli Koçollari, vep. e cituar, f. 38.

dhe që e hasim sa në Shqipëri, aq edhe në Greqi (More) apo në Itali (Piana degli Albanesi të Siçilisë).

Nga ana tjetër, në veprën e At Valentinit, vëmë re po ashtu se përgjithësisht (në shekujt XVII-XVIII), një katund shqiptar, i madh a i vogël, në çdo 100 banorë kishte mesatarisht 21-23 burra nën armë. Kjo shifër, mendojmë se duhet të ketë qenë edhe më e madhe gjatë periudhës së lulëzimit të estradiotisë shqiptarë një a dy shekuj më parë, duke pasur parasysh mobilizimin e tyre ushtarak sipas mënyrës "fshtaçe", nën prijësin apo prijësat e tyre. Pra, mesatarisht i bie që një familje stradiote shqiptare prej 12-14 anëtarësh duhet të ketë nxjerrë nga gjiri i saj 3-4 burra nën armë, gjë që do të thoshte se i pari i familjes, pasuar nga dy, tre apo katër djemtë e tij kanë qenë detyrimisht stradiotë, apo njerëz që ushtronin "zanatin" e luftës.

Së treti, elementi ushtarak shqiptar shndërruar në stradiot, u ndodh, në këtë periudhë lulëzimi të estradiotisë shqiptare, i shtrënguar të mërgojë masivisht në Perëndim, sidomos përballë pushtimit osman, pas një çerek shekulli qëndrese aktive dhe të vetmuar, ndërkohë që jeniçeria shqiptare, po e detyruar (ligji i devshirmesë), do të vepronte me po aq furi në Lindje dhe do t'u sillte shërbime të mëdha sulltanëve[11]. Dëshmitë për këtë shpërngulje të detyruar masive janë të shumta e të dhimbshme nën penën e autorëve shqiptarë e të huaj, duke filluar që nga Papa Pali II që përshkruan mjerimin e refugjatëve më 1466 : "Nuk mund t'i shohë njeriu, pa derdhur lot, këta refugjatë nëpër limanet e Italisë, të urët, të çveshur, të çkulur nga vatrat e tyre, që rrinë anësdetit dhe i ngrejnë duart në qiell dhe qajnë në një gjuhë që nuk ua marrim dot vesh".[12]

Dh.S. Shuteriqi paraqet dy eksode të rëndë që njohën "të rraskapiturit shkodranë" siç do t'i quante ai, luftëtarët e fundit të qëndresës heroike shqiptare: në vitet 1479 dhe 1501, dhe pikërisht kjo e fundit pas paqes turko-veneciane që nisi më 25 prill, ditën e Shën Markut si për ironi të fatit të shqiptarit. Për eksodin e vitit 1479, ai shkruan : "...në masën dërrmuese qenë popull i thjeshtë, mbrojtës anonimë të vendlindjes, që bashkë me gratë, fëmijët e pleqtë, i kishin shpëtuar furisë së bombardimeve osmane dhe urisë, që i kishte bërë të hanin edhe flligështirat, siç dëshmon Barleti. Sipas Beçikemit, popullsia e Shkodrës që po njihte eksodin kategorizohej më tresh : bujarët (fisnikët), pronarët (orta e mesme si dikur kalorësit romakë) dhe vegjëlia".[13]

Cituam më lart historianin francez Fernand Braudel se si shpërnguleshin luftëtarët shqiptarët fshatçe në shekullin XVI, duke u pasuar nga gratë, fëmijët dhe priftërinjtë e tyre. "Regjentët e Algjerit e të Tunisit nuk i pranuan, thotë Braudel, më pas as vendet e bojardëve moldavë e valakë. Atëherë ata dynden në shërbim të Portës... As që pyesin se ç'kamp mbronin, "Ku është kordha është besimi". Janë me atë dhe në krah të atij që i mban gjallë."[14]

Studjuesi Edwin Jacques vë në dukje se vetëm gjatë afro një shekulli (1448-1535) vetëm në Italinë e Jugut janë njohur tetë dyndje shqiptarësh dhe konkretisht :

- **1443**, Alfonsi V i Napolit pajtoi për luftë trupa shqiptare nën komandën e Dhimitër Rërës (që themeloi 13 fshatra shqiptare afër Katanzaros e në Siçili;
- **1462**, në tokat Italiane që iu falën Skënderbeut, u vendosën disa nga veteranët e lodhur nga betejat e shumta.

---

[11] Studjuesi Mihail Dimitri Strudza, duke dhënë një përkufizim të plotë për stradiotët, vë në dukje se janë "Njësi ushtarake organizuar nga republika e Venedikut dhe mbretërit e Napolit për të luftuar turqit, dhe e kundërta, njësi të vendosura për ruajtje nga Perandoria osmane kundër fuqive të krishtera, të përbërë me elementë ballkanikë, me origjinë etnike të ndryshme. Shqipëria furnizoi pjesën më të madhe të këtyre luftëtarëve, të cilëve përdoruesit e tyre u dhanë emra të ndryshëm sipas rajonit dhe fesë të cilave i përkisnin me lindjen e tyre", ("Grandes familles de Grèce, d'Albanie et de Constantinople, Paris, 1999, f. 83.)

[12] Noli, « Vepra III, Histori e Skënderbeut", f. 440.

[13] Dh. S. Shuteriqi, "Mbi Barletin dhe shkrime të tjera", Tiranë, 1979, f. 58.

[14] Fernand Braudel, vepër e cituar, f. 25-26.

- **1467**, dy katolikë shkodranë nga frika e përparimit të turqve morën Imazhin e Zonjës së Mirë (Zonja e Shkodrës) dhe e kaluan përtej Adriatikut në Genacano afër Romës. Imazhi i saj u bë shumë i njohur në besimin popullor arbëresh;

- **1468-1479**, pas vdekjes së Skënderbeut dhe rënies së Krujës e Shkodrës, mërgim i dhimbshëm : Papa Piu II përshkruan ardhjen e tyre në Itali. Përmendet në këtë kohë vendosja e familjes Albani në Romë që do të fitonte famë e pasuri në botën e artit. Shqiptarët u vendosën në Kalabri e Siçili, ku themeluan qytezat e tyre;

- **1487**, pas shtypjes së kryengritjes, Gjon Kastiotit dhe pasuesve të tij nuk iu dha strehë as në Palermo, as në Napoli nga frika se mos zemëroheshin turqit dhe u shpallnin luftë. Ndërhyri Papa që refugjatë të strehoheshin në Kalabri e Siçili. Meqënëse këta të ardhur nga Shqipëria e Jugut ishin të besimit ortodoks, gabimisht i morën për grekë dhe krahina u quajt "Piana dei Greci". Gabimi u korigjua më pas, në kohën e Musolinit,k duke u quajtur "Piana degli Albanesi";

- **1502**, vala e refugjatëve u shtua pas pushtimit turk të gjithë Shqipërisë. Sa më shumë toka zaptonin turqit në territorin grek, veçanërisht pas vitit **1535**, aq më i madh bëhej numri i popullsisë arvanite që arratisej përtej Adriatikut.

- Mërgimi përfundoi me **1774**. Shumë nga refugjatët përqafuan ritin grek sesa atë romak Kishin dy peshkopë, në Kalabri dhe në Piana degli Albanesi në Siçili.

Për të lehtësuar kalimin e tyre në ritin latin, më 1576, papa Gregori XIII themeloi kolegjin grek në Romë.

Së katërti, dukuria estradiote shqiptare është shprehje e cilësive dhe e tipareve të vetë natyrës së shqiptarit, që përputhen me shpirtin e tij të energjisë dhe të karakterit të vendosur, me zotësinë e tij ushtarake dhe cilësitë organizatore, sikurse dëshmon Prof. Çabeji. "Zotësia ushtarake, vë në dukje ai, i është e lindur kësaj race, ajo i ka ngjitur shqiptarit vulën e ushtarit të përjetshëm. "Est enim [hec] Albania regio satis lata et magna, habens homines belliscosos ualde, sunt enim optimi sagitarii et lancearii", thotë Anonimi descriptio Europae Orienalis në vitin 1308. Natyra e ushtarit është një trajtë e përbashkët karakteri, një atribut konstant i këtij kombi".[15]

Volteri, duke përmendur ushtarët albanoi (shqiptarë), do të sintetizojë në mënyrë të përkryer, historikisht, karakterin luftarak të shqiptarit:"...të mësuar të luftojnë mes shkëmbinjve, janë po ata epirotë të lashtë që kanë bërë emër për të qenë po aq luftëtarë të mirë sa dhe stërgjyshërit e tyre".[16]

Ndër vetitë fiziko-morale-ushtarake të shqiptarit, që do të ndikonin drejtpërdrejt në përsosurinë e figurës së estradiotit albanoi, në famën dhe kontributin e tij europian paguar me çmimin e gjakut, veçojmë, ndër të tjera, trimërinë apo kreshnikërinë e tij, ndershmërinë në aleanca, zellin dhe besnikërinë në të shërbyer, nuhatjen e rrezikut dhe të situatave të ndërlikuara, sidomos në shesh të luftës, hollësinë dhe prezencën e jashtëzakontë të mendjes, kurajon e lindur nga jeta me rreziqe, marrjen e iniciativës së fortë në çastin dhe në vendin e duhur. E për të plotësuar këtë portret, Prof. Çabeji do të vijojë me tipare të tjera të shqiptarit, duke nënvizuar se "shpirti i tij është rezervimi, i matur, i mbyllur, i rezervuar, sidomos me të huajin, por ky rezervim nuk e përjashton edhe karakterin e hapjes, ka dhelpërinë e lindur të banorit të maleve, ka shenjë individualisti dhe rezervimi që në raste të veçanta i kthehet në qëndrim të egër e kokëfortë" Por mbi të gjitha, ai veçon krenarinë e pafre, ndershmërinë, si "mik i së vërtetës". [17]

Ndër veti të tjera që e plotësojnë portretin e shqiptarit janë edhe dështira për shtegtim dhe malli i tokës së lënë, këmbëngulja në jetë dhe fuqia e personalitetit. Nën kërcënimin e egër të përditshëm të pushtimit të vendit, Barleti nuk mungon ta paraqesë shqiptarin madhështor në zjarrin e luftës, duke lëruar arën me njërën dorë dhe duke mbajtur shpatën në dorën tjetër. Një vlerësim i veçantë e i bukur për shqiptarin jepet sidomos në një *Fjalor të bisedimit e të leximit*

---

[15] Eqerem Çabej "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", MÇM, Tiranë 1994, f. 27.

[16] Volter, "Përmbledhje për shekullin e Luigjit XV", kreu 21, revolucioni i Gjenovas, fillimi i shek. XVIII. dok. el.

[17] E. Çabej, vep. e cit. f. 27.

të vitit 1833, kur thuhet në zërin arnaut : "Vlera e tyre është proverbiale...Vlera e tyre i bën ata të mirëpriten me zell nga turqit,[18] që u kanë dhënë për këtë arsye, siç thuhet, emrin *Arnautë*. Vërejmë këtu se *arnaodh* në gjuhën galike do të thotë trim, kreshnik, nga *naodh*, që do të thotë vlerë"[19].

Studjuesi Henry Castell, me të drejtë jep këtë vlerësim për shqiptarët : "...të quajtur nga italianët stradioti, ose ndryshe albanoi apo grekë, ata kanë namin si të krishterë shumë të mirë, dhe nga ana "tjetër janë aq të guximshëm e trima, sa nuk duan të jenë shtetas të askujt; përpiqen të qeverisin aq mirë midis tyre... dhe duke i pajisur aq mirë kështjellat e tyre, ndonëse në vende të shkreta dhe gati të paarritshme, saqë turku kurrë nuk ka ditur t'i nënshtrojë e t'i skllavërojë".[20] Vite më pas, më 1799, Napoleon Bonaparti, që do t'i njhte shqiptarët dhe do të kishte edhe një regjiment shqiptarësh në ushtrinë e tij, do t'i shkruante gjeneralit Desaiks gjatë ekspeditës së Egjiptit se "arnautët, mograbinët, naplusinët janë pa mëdyshje trupat më të mira të Europës".[21]

Tepër domethënëse në këtë drejtim janë fjalët e historianit tjetër të shquar francez J.C.L. Sismonde de Sismondi, i cili, për periudhën 1454-1470, vë në dukje: "Shqiptarët, ilirët, ishin krejt të ndryshëm nga grekët, nuk pranonin t'u bihej më qafë apo të shtroheshin urtë e butë për punë, por ishin nga ana tjetër energjikë e të guximshëm. Republika [venedikase] do kish gjetur tek ata ushtarët e vet më të mirë, marinarët më të mirë, po të kish dashur t'i trajtonte me barazi të plotë në ushtritë dhe flotat e saj."[22] Kurse studjuesi Edouard Laboulaye do të shprehet : "Lufta [për ta] është i vetmi mjet që u jep pasuri e nder... vetë Europa i ka pasur në shërbim të saj mëse një herë; ka pasur mirditas në shërbim të Napolit e të Austrisë, ka pasur në Francë në kohën e Henri IV".[23] Murgu francez Jean Claude Faveyrial, që ka hartuar i pari "Historinë e Shqipërisë", duke folur për cilësitë e shqiptarëve, thotë se nën Luigjin XIII, misionarët francezë që vizituan Shqipërinë "u mbërthyen nga admirimi tek panë këtë racë me shpirt të fuqishëm, shtatin e lartë, tiparet e ashpra, armët e zbukuruara".[24]

Së pesti, dukuria estradiote shqiptare është shprehje e artit të lashtë ushtarak shqiptar, përsosur në periudhën e Skënderbeut, është kontribut me vlerë në artin ushtarak europian duke futur në të, për herë të parë, taktikën dhe strategjinë e kalorësisë së lehtë shqiptare, sintetizuar në dy veprat e komisarit të përgjithshëm të kalorësisë, shqiptarit Gjergj Basta, "Mbi qeverisjen e kalorësisë së lehtë" (1612) dhe "Detyrat e shtatmadhorisë" (1606).

Orientalisti i mirënjohur grek N. Sathas, me shumë guxim e të drejtë, do të vinte pikërisht në dukje se "Arti i tyre luftarak ishte themeli i strategjisë së mëpasshme europiane, sado e çuditshme të duket kjo".[25] Studjuesi bashkëkohor Nicholas C.J.Pappas i sheh stradiotët, "në pjesën më të madhe me origjinë nga Shqipëria, si pionerë të taktikave të kalorësisë së lehtë në ushtritë europiane të kohëve moderne"[26] Aristidh Kola, përmend ndër stradiotët e mëdhenj Mërkur Buan e Manol Bleshin, të cilët, ashtu sikurse Marko Boçari shekuj më pas, studjonin betejat e Skënderbeut, dhe librat e Barletit për Heroin e Arbërisë e të Epirit ishin përgjithësisht ndër më të përhapurat në radhët e stradiotëve shqiptarë[27]. Dhe ishte pikërisht ajka e ushtrisë së tij, garda skënderbejane - ajo që zotëronte në mënyrë të përkryer strategjinë dhe taktikat e luftës rrufe, ajo që kishte njohur vetëm fitore për një çerek shekulli përballë

---

[18] Është periudha kur shqiptarët, si u lodhën duke vështruar nga Perëndimi e duke pritur ndërhyrjen e tij në Shqipëri e Ballkan, ndërruan në numër të madh fenë në shekullin XIX, duke u shndërruar në myslimanë.

[19] "Dictionnaire de la Conversation et de la lecture", vëll. 3, Paris, 1833f. 167.

[20] R.P.F. Henry Castell, « Le Sainct voyage de Herusalem et Mont Sinai, 1600 », Bordeau, 1603, f. 56.

[21] Vepra të N. Bonapartit, vëll. 13, 1821, letër e 30 zherminalit të vitit 7, dmth 19 prill 1799. dok. el.

[22] J.C.L. Sismonde de Sismondi, "Histoire de la Renaissance de la liberté en Italie", vëll. 1, Paris 1835, f. 92.

[23] Edouard Laboulaye, "Etude contemporaine sur l'Allemagne et les pays sllaves", Paris 1856, f. 200-2001.

[24] J.C. Faveyrial, "Histoire de l'Albanie", botim i hartuar e i paraqitur nga R. Elsie, Pejë 2001, f. 219.

[25] Aristidh Kola, "Arvanitasit", Shtëpia botuese 55, Tiranë 2002, f. 148.

[26] "Stradioti: Balkan mercenaries in fifteenth and sixteenth century Italy", dok. el.

[27] A. Kola, vepër e cit., f. 247.

ushtrive të panumërta perandorake osmane -, që do të shndërrohej më pas në ushtri estradiote shqiptare të shpërbërë në krejt Perëndimin europian.

Përballë armikut, ata dinin të vepronin me zgjuarsi dhe nuk ishin aspak "mish për top", për të shkuar në luftë "oburra rrëmujçe", siç duan t'i paraqesin disa kronikas. Ata studjonin fuqinë e kundërshtarit, terrenin dhe elementë të tjerë të betejës, zinin më pas prita, i linin kundërshtarit në fillim të përleshjes përshtypjen se po tërhiqeshin, dhe kur kundërshtari u binte pas dhe humbiste kompaktësinë mbrojtëse, ata riktheheshin për të goditur kësaj radhe më fort duke i shpartalluar. Pra thotë studjuesi Kola, "gjysmë të zhveshur, ata mposhtnin kalorësit e hekurt". Ata e njihnin përgjigjen e Skënderbeut drejtuar sulltan Mehmetit kthyer në sentencë të famshme :"Të dhashë shpatën, por jo krahun", që do të thotë këtu krahu i komanduar nga truri. Vepronin kështu me mençuri të hollë në shesh të betejës.[28] "Fryma heroike që kishte përhapur Skënderbeu si gjysmë perëndi e vjetërsisë [lashtësisë], thotë Noli rronte e gjallë në zemrat e shqiptarëve vjete pasi fluturonj në qjell shpirti i ndriçëm i kryetrimit"[29]. Dhe ishin pikërisht mendja, shpriti, shembulli dhe krahu i tij themeli i përsosurisë së artit ushtarak të shqiptarëve, që kishte trashëguar që nga Aleksandri i Madh, që nga Pirroja dhe mbretërit ilirë tërë mjeshtërinë historike të këtij arti. A nuk thekson me të drejtë Prof. Mark Tirta se "ndër ilirë, është dëshmuar gjerësisht kulti i hyjnisë kalorës luftëtar"? Dhe ndër ta, ai përmend hyjninë kalorës të Japodëve, Medaurusin, paraqitur hipur mbi kalë e me shtizë në dorën e majtë. Madje, në çdo fillim beteje, ilirët do flijonin kuaj për të siguruar fitore në luftë.[30]

R.P.Daniel, i Kompanisë së Jezusit, në veprën e tij *Histori e Milicisë franceze* (1721), jep këtë përkufizim për stradiotët : "Si kalorësi e lehtë, ata ishin një Milici ... U quajt në Francë kjo Milici *kalorësia shqiptare*".[31] Citon kronistin De Brantome, i cili thekson nga ana e tij se Mbreti Luigji XII i caktoi zotërisë De Fontrailles detyrën e gjeneral-kolonelit të albanojëve në shërbim të tij (2000 trupa të komanduar nga kapiteni shqiptar Mërkur Bua) dhe që "janë ata që na sollën formën e Kalorësisë së lehtë, e cila deri në atë kohë pak vlerësohej në Francë". Nga ana tjetër, Fisniku De Langey thotë për ta se mund t'i vije për të luftuar edhe si këmbësorë.

Duke shpjeguar termat *armatosur lehtë*, Ati Daniel nuk mungon të nxjerrë në pah pikërisht zanafillën antike të vetë këtij koncepti nëpërmjet figurës së Aleksandrit të Madh, armatosur thjesht me heshtë e mburojë majë Bucefalit të tij (*Chronicon Comariense ad an. 1298).*[32] Por krahas birit të shqiptares Olimbia, të njëjtën gjë mund të themi edhe për Pirro Epirotin, që futi për herë të parë kalorësinë e lehtë në perandorinë romake, për Skënderbeun dhe gardën e tij, pjesë nga e cila vetë Heroi ia dhuroi mbretërisë së Napolit sa ishte gjallë, gjë që dëshmon se kalorësia e lehtë shqiptare e të gjitha kohërave ka shkëlqyer përgjatë shekujve dhe do bëhej, si rrjedhim logjik, themeli i kalorësisë së lehtë europiane të modernizuar, një nga kontributet më me vlerë të kombit të lashtë shqiptar në historinë europiane e botërore.

Nga ana tjetër, Ati Daniel, duke vënë pikat mbi "i" për mjaft çështje të diskutueshme të Historisë së Milicisë franceze, do të sqaronte se kalorësia e lehtë franceze më përpara nuk përbënte aspak një trupë ushtarake të rregullt dhe se "Vetëm që prej kohës së Luigjit XII apo pak më parë zë fill historia e kalorësisë së lehtë të Francës". Dhe pikërisht, në artin e luftës së kohës së Luigjit XII estradiotia shqiptare mori rëndësi të veçantë për vetë karakteristikat e saj të luftimit, duke u veshur kësisoj me funksionin dhe formën e kalorësisë së rregullt në ushtrinë franceze e më tej. Këtë e dëshmojnë, ndër të tjerë, Konti Bussi de Rabutin dhe kronisti De Brantôme, të cilët shprehin të njëjtën pikëpamje kur thonë se në Francë "u muar për model kalorësia shqiptare, së cilës iu dha emri estradiotë apo stradiotë". Në këtë mënyrë, kalorësia e lehtë franceze u formua sipas modelit të kalorësisë shqiptare.

Mirëpo, lidhur me këtë çështje, Ati Daniel, që i përket shekullit XVIII, sikur e redukton rolin e kësaj kalorësie thjesht në "trupë të veçantë", tek i sheh stradiotët si "trupë më vete,

---

[28] Po aty, f. 288.
[29] Noli, vepër e cituar, f. 347.
[30] Mark Tirta, "Mitologjia ndër shqiptarët", Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2004, f. 36.
[31] R.P.Daniel, Histoire de la Milice française", Paris 1721, vëll. 1, f. 229-236.
[32] Po aty, vëll. 2 f. 437.

ashtu si në ushtritë e turëve dhe ato të venedikasve".[33] Një pikëpamje e tillë, për mendimin tonë, sikur e kufizon rolin e kësaj kalorësie, duke e parë thjesht si një trupë mbështetëse apo ndihmëse të ushtrisë (pra duke i njohur rol të dorës së dytë), dhe jo si një trupë me funksione të plota e të përcaktuara. Ky koncept për mendimin tonë e ka zanafillën në faktin se ende në atë kohë, rol kryesor në artin ushtarak i jepej këmbësorisë dhe artilerisë së rëndë në prag të atij që është quajtur "revolucion ushtarak", mbështetur mbi fuqinë e zjarrit. Edhe pse kalorësisë së lehtë iu njohën vlerat e saj të pamohueshme për kohën, përsëri roli i saj vazhdonte të paragjykohej.

Kronistët vëllezër Martin dhe Gijom Du Bellay në kujtimet e tyre parashtrojnë tre funksione kryesore të kalorësisë së lehtë estradiote:

- për të hutuar trupat e xhandërmarisë së rëndë (çoroditje e panik në radhët e ushtrisë armike);
- për të bërë asgjësimin përfundimtar kur fillon thyerja e tërheqja (për t'i rënë pas këmbësorisë pas disfatës);
- për të përfunduar suksesin e për të bërë robër.

Po ashtu funksione të tjera ishin shoqërimi i trupave në marshim, vënia e saj në pararojë si dhe sigurimi i prapavijës. Tek *Kujtimet* e Filipit të Kominëve i shohim kështu estradiotët të sulmojnë pararojën e ushtrisë së mbretit të Francës në Fornovë, të godasin natën fushimet e të ngjallin panik, të sulmojnë prapavijat, të dëmtojnë rëndë ushtrinë kundërshtare në marshim, madje edhe të zënë robër të rëndësishëm, si kardinalin e Sent Malosë. Thuhej për ta se godisnin shpejt e beftë, dhe se tërhiqeshin po aq shpejt, se kishin pak të vrarë në radhët e tyre, se bëheshin të rrezikshëm kur zinin prita, se shmangnin goditjet frontale dhe se përpara rrezikut bëheshin erë. Këtë taktikë të tyre të "luftës rrufe" apo luftës së shpejtë, shkrimtari i mirënjohur francez Zhan Maroti e ka përcaktuar bukur në librin e tij "Udhëtim në Venedik" kur thotë për shqiptarët: "Shkojnë me aq shpejtësi, sa duket sikur janë stuhi". Dhe që këtej vetë shprehja e Marotit: "Krenar si stradiotët", "Krenar si shqiptarët". Por, disa shprehje të tjera në gjuhën frënge do të sintetizonin po aq bukur në atë periudhë vetë taktikat e zhdërvjellëta që përdornin stradiotët shqiptarë në Perëndim :

- *ébourrer la mélée,* që do të thotë literalisht – *ta mbushësh përleshjen*, për të cilën jepet shpjegimi : mënyra albanuaze (shqiptare) është kacafytja e shpejtë, domethënë ta ndezësh mirë përleshjen, pastaj të tërhiqesh nga sheshi i betejës, me t'u dhënë sinjali (sipas Merlin Cocaie, vëll. 2 f. 239);
- *chevaucher à l'albanoise – kalëron sipas mënyrës albanoi,* për të cilën jepet shpjegimi: prek me gjunjë gati qemerin e shalës, duke u mbledhur krejt, apo i bërë njësh me kalin (sipas "Collection complètes des Mémoires relatifs à l'Histoire de France", nga M. Petitot, vëll. 24, Paris 1822, f. 315). Vihet në dukje se kjo shprehje është përmendur për herë të parë gjatë festimeve me rastin e hyrjes në qytetin e Gjenovas të Pierre de la Baume më 11 prill 1523, kur kalorës të rinj, veshur e pajisur mirë kalëruan *à l'albanoise* (alla shqiptarçe); nga ana tjetër, Fjalori me emër i Jean Nicot-it "Thesar i gjuhës frënge" (1606) jep këtë shpjegim për shprehjen : "*të kalërosh si stradiot*, domethënë me yzengji të gjata, ndryshe nga gineta spanjolle me yzengji të shkurtra".
- *"u shpofsh nga pas nga ndoca albanoi"*, shprehje sharëse e Rablesë me kuptim alegorik; në shënimin përkatës jepet shpjegimi se "milicia shqiptare ishte e mirë për t'iu qepur arratisësve dhe për t'i shpuar nga pas me majën e heshtës."

Duke folur për betejën e Fornovës më 1495, midis francezëve dhe venedikasve, historiani M. Garnier thekson : "Sado e fuqishme të shfaqej ushtria franceze, ajo e Venedikut e tejkalonte më së shumti...[Venediku] mblodhi në një kamp të vetëm 3000 heshtarë, 4000 stradiotë apo shqiptarë, *kalorësia më e mirë e lehtë që njihej gjer atëherë* (nënvizimi im,

[33] Po aty, f. 440.

F.A.)... Për më tepër, ata [stradiotët] nuk luftonin aspak në këmbë, por vetëm në formacion trupash të shkëlqyera të kalorësisë së lehtë".[34] Po ashtu, në një botim të vitit 1782 vihej në dukje se ata ishin të tërë tepër të dobishëm gjatë një aksioni, sepse ishin më lehtë të armatosur nga xhandarmëria, të cilën mund ta godisnin herë pas here duke i marrë krahët, apo duke e goditur nga pas. Luftonin në ndonjë rast në këmbë me zagaje, apo me shkopa të drunjtë me skaje të hekurt, që shndërrohej në duart e tyre në armë tepër të rrezikshme.[35]

Përgjithësisht, është e njohur që stradiotët, në pjesën më të madhe të tyre, janë shqiptarë[36], por shpesh, vetë këta cilësohen edhe stradiotë grekë, për këto arsye:

a. për shkak të origjinës së tyre arvanitase që me formimin e stratopive në shekullin XI-XII, siç e pamë edhe më lart ; vetë termi grek "stradiot", shndërrohet shpesh në ngatërresë për origjinën e stradiotëve : (është përjashtuar këtu plotësisht etimologjia e fjalës "stradiot" nga termi italin "strada", dmth "njeri që rreh rrugët";
b. për shkak të vërshimit të tyre në numër të madh nga zonat jugore të Shqipërisë, nga Epiri dhe nga zonat greke banuar edhe nga arvanitas[37] (Moreja, Korfuzi dhe ishujt);
c. për shkak të gjuhës greke që përdornin lirshëm arvanitasit dhe epirotët;
d. për shkak të fesë ortodokse që praktikonin shqiptarët e jugut, epirotët dhe arvanitasit, në kontakt dhe lidhje të ngushtë me popullstë greke.

Megjithatë, duhet theksuar se në ato kohë kur mercenarizmi lulëzonte në Europë, në radhët e shumta të stradiotëve kishte domosdo edhe luftëtarë grekë, kroatë (nga ku vjen prej stradiotëve kroatë fjala "kravatë" për shkak të shallit-rrip që mbanin varur përpara), boshnjakë, bullgarë, vllehë, rumunë, maqedonas, e të tjerë ballkanikë, që ashtu si mercenarët perëndimorë, formonin kompani të shumta dhe drejtoheshin kryesisht nga kapitenë vendas, sikurse ndodhte me stradiotët shqiptarë, të cilët përherë do kishin prijësat e tyre dhe zor se viheshin nën komandën e drejtpërdrejtë të të tjerëve. Dhe kjo, thjesht për arsye komunikimi. Lidhur me veshjen dhe pajimet, fisniku Montgommeri Courbousson na jep një përshkrim të hollësishëm : mëngë të thurura, dorashka po të thurura, shpatë me faqe të gjerë nga njëra anë, topuz, zagajë (lloj heshte), që e quajnë arzegajë (apo arzëgejë), e gjatë dhjetë deri në dymbëdhjetë këmbë, me të dy majat e hekurta, jelek të shkurtër e pa mëngë.

Mbanin banderolë në majë të heshtës për të bërë grumbullimin e tyre dhe kishin mbi krye një saladë me strehë të shkurtër.[38] Një stradiot i tillë shqiptar i kësaj kohe është ilustruar bukur në veprën *Historia e Milicisë* të atit Daniel të vitit 1721 (foto 27), në Veprën e Colonel Hardy de Perini "Betejat franceze (1562-1620)" (foto 28), si dhe në disa gravura të mëvonshme të shekujve XVIII-XIX për kalorësinë e lehtë franceze. Përsa i përket përshkrimit fizik, sikurse vëmë re edhe nga disa gravura e statueta stradiotësh (Del Prado, etj.), ata na

---

[34] M. Garnier, "Histoire de France", vëll. 20, Paris 1768, f.174, 424.
[35] "De la lecture des livres françois", shek. XVI, Paris 1782, f. 7.
[36] Aristidh Kola duke u mbështetur te historiani dhe filologu i shquari orientalist Konstandin Sathas thotë se tek stradiotët e Venedikut 80-90 % ishin shqiptarë. A. Kola, vepër e cit. f. 239-244.
[37] Historiani C.-D. Raffenel, në veprën e tij « Histoire des grecs modernes » vë në dukje : "Banorët gadishullit [Peloponezit], të lodhur nga krizat që rrënonin pa pushim vatrat e tyre të varfëra nuk merrnin aspak pjesë në përplasje me shtypësit e tyre. Prej kohësh nuk mbanin armë; të mësuar për t'u bërë pre e më të fortit, shihnin me të njëjtën moskokëçarje ngadhënjimet apo dështimet e tiranëve që haheshin kush e kush t'i sundonte. Një despotizëm i tmerrshëm e kishte çuar dështërimin e tyre deri në këtë pikë...Të pafatët peloponezianë ishin pra nënshtruar pa e hapur gojën, si të mësuar me një gjë të tillë; as që e kishin për gjë të kultivonin arat e tyre për myslimanët, apo të shihnin se si u rrëmbeheshin të lashtat nga tiranë të krishterë. Shqiptarët, që nuk kishin të njëjtat arsye për t'u nënshtruar, u vendosën në malet e Lakonisë, dhe pasi goditën shumë herë trupat e sulltanit, kaluan edhe vetë në shërbim të pashallarëve të tyre. Megjithatë, disa prej tyre, nuk hoqën dorë nga pavarësia, e sidomos nga feja e të parëve, parapëlqyen më mirë një jetë aventureske në tërheqjen që kishin bërë dhe mbetën në gjendjen kryengritëse të hapur e të përhershme. Kjo mund të jetë origjina e atyre luftëtarëve të pamposhtur që më vonë do ta bënin gjysmëhënën të zbehej e t'i jepte lirinë Greqisë". "Histori e grekëve modernë", Paris 1825, f. 41-43.
[38] R.P. Daniel, vep. e cit. f. 229-236.

shfaqen tepër mjekëroshë (foto 29), pa armaturë tupore e pa kofsharë mbrojtjeje, thjesht me një mburojë të vogël në dorë (targetën) dhe me shtizën në dorën tjetër. Filipi i Kominëve, që shoqëroi Karlin VIII në betejat e Italisë i njohu stradiotët shqiptarë gjatë betejës së Fornovës dhe thotë për ta se mbanin me vete një kaftan të ngjeshur dhe kreun e parë të Ungjillit sipas Janit, për t'i mbrojtur në luftë.

foto 27, stradiot, Ati G.Daniel, "Histroi e milicisë".



foto 28, H.de Perini, stradiot shqiptar, "Betejat franceze, 1562-1620".

Mbulesa tipike e kokës ishte plisi i lartë, i quajtur "albanua", siç e pamë edhe më lart. Vëmë në dukje gjithashtu, si armë kryesore të tyre heshtën e gjatë mbi tre metra (3,60m), të cilën nuk e mbanin nën sqetull siç ishte zakoni në Europë që nga Mesjeta e hershme, por që e mbanin "në mënyrën orientale", domethënë përsipër krahut të përthyer nga lart. Një nga ushtrimet kryesore të tyre ishte të përdornin sa më mirë këtë armë me të dyja duart, duke goditur herë me njërën majë dhe herë me tjetrën. ("Enciklopedia apo Fjalori shpjegues i shkencave, zanateve, arteve", i Didëroit dhe d'Alemberit, zëri "Kalorësi"). Valter Skoti, siç theksuam, i sheh të veshur gjysmë europiançe, gjysmë orientalçe. Mbanin, sipas tij, parzmore të shkurtër dhe përsipër një tunikë me cohë shumëngjyrëshe, me pantallona të gjera dhe gjysmë çizme, mbanin mburoja të vogla të rrumbullakta, hark dhe shigjeta, kama e shpata. Ngisnin kuaj të përzgjedhur, të mirëmbajtur me shpenzimet e Republikës së Venedikut. Takëmet dhe shala e kuajve, thotë ai, përngjanin me ato të turqve dhe i ngisnin kuajt në të njëjtën mënyrë, mbi një ndenjëse të ngritur e frerë të shkurtër. Ishin trupa shumë të dobishme për prita.[39]

[39] Valter Skot, "Hajmalia", përkthim në frëngjisht nga A.Montemont, Paris, 1837, f. 266.

foto 29, stradiot, shek. XVI.



foto 30, arkëbuzier e stradiot, shek. XVII.

Historiografia ushtarake frënge ia njeh Luigjit XII zanafillën e kalorësisë së lehtë franceze, krijuar më 1509 sipas një urdhërese të tij, në të cilën mbreti urdhëronte krijimin e kompanive të kalorësisë së lehtë duke u caktuar pagesë dhe duke i vënë nën komandën e gjeneral-kapitenit të albanojëve. Mirëpo, nuk mungojnë edhe autorë që pretendojnë se kalorësia franceze zë fill në kohën e Karlit VIII të Francës, kur ai shkoi në Itali dhe ku u takua "me një fisnik albanoi të quajtur Georges Castriotte,[40] [i cili] erdhi e u bashkua me të, duke i sjellur 400 shtiza morleske (nga Moreja), të cilat prej asaj kohe janë quajtur 'kupi' (prerëse, grirëse) dhe më të gjata nga ato që mbanin xhandarët francezë... Si u largua Zhorzh [Gjon] Kastrioti, duka i Mantusë, (që në atë ohë kishte titullin e markezit) u dha tek mbreti, duke i kërkuar komandën e kalorësisë, e cila iu dha dhe e shtoi trupën e tij që u bë njëmijë kuaj (të lehtë). Kur markezi i Mantusë iu largua palës së mbretit për të ndjekur atë të Papës Juli e të venedikasve, francezët - që rendin kollaj pas gjërave të reja, të cilave u ndryshojnë emrin për të qenë më të leverdisshme për shërbimin e tyre -, i dhanë një emër kësaj trupe, që e quajtën kalërosi e lehtë."[41]

Mirëpo, i këtij mendimi nuk është Ati Daniel, që këmbëngul se zanafilla e kalorësisë së lehtë është pak para kohës së Luigjit XII, me argumentimin se Filipi i Kominëve, dëshmitar okular "sur place" nuk flet për një gjë të tillë, për këtë takim të Gjon Kastriotit me mbretin Karli VIII. Nga ana tjetër, Enciklopedia e Didëroit dhe e D'Alemberit vë thjesht në dukje se "Stradiotët ishin një milici, të cilët u njohën prej francezëve gjatë luftrave të Italisë nën Karlin VIII, siç vëren Komini". Kurse autorë të tjerë të mëvonshëm si J. Mathorez, shprehen se "Ka të ngjarë që Karli VIII, i cili, pasi konstatoi gjatë betejës së Fornovës që kalorësia shqiptare në shërbim të Republikës së Venedikut krijonte një trupër gjurmuesish të shquar, u përpoq të rekrutonte për ushtrinë e tij disa toga shqiptarësh. Megjithatë, nuk është e sigurt".[42]

Kalorësia e parë e rregullt u quajt ajo e kuajve të lehtë dhe e karabinëve, duke qenë se ishin të armatosur lehtë në krahasim me trupat e xhandarmërisë armatosur nga koka në këmbë. U nda në kompani me treqind a katërqind "mjeshtra" secila, sa albanoi dhe francezë.[43] Në fakt, siç vë në dukje Pierre Wadal, "E ardhmja i takon kalit të lehtësuar, andaj dhe mercenarë të huaj rekrutohen në rast nevoje për të përmbushur luftimin me heshtë". Dhe duhet pasur parasysh që mercenarët e huaj (stradiotët shqiptarë, gjeneterët spanjollë, kalorësit gjermanë, zvicerianë, irlandezë, gaskonë, etj përbënin - në trupat franceze të këmbësorisë e të kalorësisë, kur Franca numëronte në atë kohë një popullsi prej 18 milionë banorësh -, midis

[40] Është fjala për Gjon Kastriotin, të birin e Skënderbeut, përderisa jemi në vitet 1495-1498, ngatërresë emri që bëhej shpesh në atë kohë nga kronistët.

[41] Roger de Rabutin, kont i Busisë, « Traktat i kalorësisë së lehtë franceze », « Mémoires de Messire Roger de Rabutin", vëll. 2, f. 139.

[42] J. Mathorez, vepër e cit. f. 196-197.

[43] "Etat general des troupes françoises du roi", 1735, f. 166 : Kreu "Kalorësia e lehtë franceze dhe e huaj", janar 1735, doc. el.

50% dhe 25% të efektivave të ushtrisë franceze.[44] "Nisur në Itali me një kalorësi të rëndë, thotë studjuesi Denis Borgos në analizën e tij për ekitacionin arab, francezët do të rikthehen prej saj me një kalorësi të lehtë, duke sjellë me vete "arguletët" (nga Argolida) dhe stradiotët (nga Shqipëria)".

Fransuai i Parë ndoqi të njëjtin plan të Luigjit XII dhe organizoi një trupë të posaçme kalorësisht të lehtë (1523), shtoi numrin dhe më 1543, shohim Dë Brisakun në krye të 1500 kalorësve në ushtritë e Vendeve të Ulta ku kishte stradiotë apo albanoi komanduar nga kapiteni shqiptar Teodor Bëdenja (apo Theod Bedaine). Nën Henrin II, kalorësia e lehtë u shtua dhe shohim më 1552, 3000 kalorës të lehtë, por tashmë drejtuar – thonë vëllezërit kronistë Martin et Gillaume du Bellaye -, nga fisnikë francezë dhe jo kapitenë mercenarë. Kalorësia në këtë kohë merr formë krejt të rregullt, pagë, bëhet organizimi i ri nëpër kompani, duke marrë kështu formë milicie. Lulëzimin e saj, kalorësia e lehtë franceze e njohu nën Henrin IV gjatë luftrave civile (fetare).[45]

Betejat dhe aksionet kryesore të stradiotëve shqiptarë e ballkanas të kësaj periudhe të lulëzimit të tyre janë :

Beteja e Fornovës, 5 korrik 1495, përleshje të vazhdueshme midis gjurmuesve francezë dhe stradiotëve shqiptarë rekrutuar nga Venediku; 6 korrik fitore e plotë e francezëve, që në pjesën më të madhe, është rezultat i armatimit francez, artilerisë[46] dhe heshtave më të shkurtëra zviceriane, në krahasim me heshtat stradiote të gjata 3,60m, si dhe të terrenit të favorshëm. Ati Daniel, lidhur me këtë betejë do të shkruante : "Stradiotët lënë formacionin e rregullt të luftimit dhe i lëshuten prapavijës... Pa dyshim, sikur njëmijë e pesëqind kalorës të lehtë të ishin futur në radhët tona me kordhë [jataganë] në dorë, që janë shpata të tmerrshme, po të kemi parasysh që ishin në numër të pakët, do të ishim thyer mos më keq. Perëndia na erdhi në ndihmë, duke qenë se stradiotët u larguan, kurse italianët, të gjithë filluan t'ia mbathin"[47].

Beteja e Padovas, 1509 – mbrojtja kryesore e qytetit ishin 2000 kalorës albanoi që ndodheshin brenda saj dhe që bënin inkursione të vazhdueshme çdo ditë, duke e lodhur dhe duke e ngacmuar papushim ushtrinë perandorake (a nuk të kujton kjo rrethimet e Krujës dhe inkursionet skënderbejane?), pa i lënë kohë kundërshtarit të organizohej e të merrte frymë.[48]

Në këtë betejë, krahas Mërkur Buas, fisnikut të Saizës në shërbim të perandorit francez, na shfaqet edhe Skënderbeu i Ri (djali i Gjonit) me 200 albanoi në mbrojtje të kështjellës së Bassanos gjatë rrethimit të Padovas. Të dy trimat shqiptarë janë kundërshtarë me shoshoq, madje Bajardi, fisniku francez i mbiquajtur "Kalorësi pa frikë e pa qortesë", një nga kronikasit më të mirë të kohës dhe një nga kreshnikët e ushtrisë franceze, flet për betejat e para kur gjatë përplasjes së trupave, nga pala frënge (ku kish edhe albanoi) thirrej: "Për Perandorin, për Francën!" dhe nga pala shqiptare në shërbim të venedikasve thirrej: "Për Markon, për Markon!", domethënë për Republikën e Shën-Markut. Bayard, duke përdorur spiunë, i ngre kurth Skënderbeut të Ri, duke i zënë urën e vetme nga kalonin për të hyrë e për të dalë nga kështjella, duke e tërhequr në rrëzë të malit. Shqiptarët bien në pritë. Mbetën të vrarë 12 stradiotë, të tjerët tërhiqen drejt kështjellës, por ura qe në duart e kundërshtarit. Të ndodhur mes dy zjarresh, bien robër 60 albanoi së bashku me Skënderbeun e Ri dhe kapitenin italian Contarini. Kalorësi fisnik Bayard i trajton me fisnikëri, i grish në trapez dhe u kërkon të dorëzojnë kështjellën që komandohej nga nipi i Skënderbeut të Ri. Kështjella u dorëzua dhe

---

[44] Pierre Wadel, "La cavalerie de l'Ancien Régime en Champagne méridionale", dok. el. Studjuesi J. Mathorez, në veprën e tij "Les étrangers en France sous l'ancien régime", do të vinte në dukje : "Të gjithë këta kanë lënë gjurmë të kalimit të tyre në popullsinë franceze". (vëll. 1, Paris, 1919, f. 65).

[45] Martin et Guillaume du Bellay, vepër e cit. f. 404-408.

[46] Disa autorë kanë këmbëngulur se përpara goditjeve të artilerisë franceze, kuajt e stradiotëve u trembën dhe ata iu lëshutën bagazheve, apo prapavijave për plaçkitje, duke hequr kështu dorë nga luftimi.

[47] Ati G. Daniel, "Histoire de France", vëll 11, Paris 175o5, f. 461-465.

[48] Abati Fleur, "Histoire ecclésiastique", vëll. 25, Paris 1729, f. 33-36.

ky episod do bënte bujë në ushtrinë franceze. Lihet të kuptohet se Skënderbeu i Ri duhet të jetë liruar kundrejt një pagese (rançon) sipas rregullave të luftës kalorësiake të kohës[49].

Aksioni për furnizimin me ushqime të qytetit Teruenë rrethuar prej dy muajsh, 1512-1513, - Me urdhër të drejtpërdrejtë të Luigjit XII u dërgua fisniku Fontrailles, kapiten i përgjithshëm i stradiotëve albanoi për të çuar fshehtas furnizime me ushqime në qytet. Çdo kalorësi albanoi iu ngarkua mbi qafë të kalit një kofshë mishi dhe një torbë barut për topat dhe t'i vërvisnin këto përmbi muret e qytetit. Operacioni u krye me sukses; përmendet këtu kapiteni albanoi Theod Bedena me 200 stradiotët e tij[50]. Ky kapiten përmendet gjithashtu edhe në Kujtimet e fisnikut të Villars-it.

Ekspeditat në Vendet e Ulta e në Gjermani (1542-1543) – 1500 kalorës të lehtë nën drejtimin e Fisnikut Brissak dhe 3000 kalorës të lehtë nën Henrin II.

Luftrat civile në Francë gjatë mbretërimit të Henrit IV – stradiotët shqiptarë vazhdojnë të jenë të shumtë në numër dhe tepër aktivë.

Beteja e Kutras, 1587, përmendet mjaft herë kapiteni Mërkur (ndoshta nipi i Mërkur Buas) si komandant i një trupe albanoi në regjimentin e Lavardinit që i shërbente Dukës Anne de Joyeuse gjatë luftrave fetare të katolikëve (papistëve) kundër protestantëve (hugënotëve). Lavardini sulmon eskuadronin e Tremujës dhe Mërkuri atë të Aremburës. Përmendet Kapiten Merkuri dhe markezi Lavardin edhe te "Mémuaret e Lidhjes" e sidomos te "Fjalori i ri historik i rrethimeve dhe betejave të paharruara", ku thuhet për ta se u lëshutën me aq vrull mbi trupën e Tremujës e të Haramburit, sa i çanë tejpërtej. Në këtë betejë katolikët, ku bënin pjesë edhe stradiotët albanoi, humbasin rëndë. Pjesa më e madhe e kalorësisë u asgjësua[51].

Sigurisht, në betejat e shumta të stradiotëve shqiptarë për më shumë se dy shekuj, në vende dhe në kampe të ndryshme, qoftë edhe kundërshtare, nuk mungojnë mjaft episode, sa heroike, aq edhe tragjike, sidomos vëllavrasjet. Po përmendim disa prej tyre për efekt historik:

- Në Parma (nëntor-dhjetor 1510) ishin krijuar dy kampe kundërshtare, njëri drejtuar nga fisniku spanjoll Perlate (aleat i Papës) dhe tjetri nga fisniku spanjoll Alando (aleat i francezëve, kundër Papës); në të dy kampet shërbenin stradiotë shqiptarë. Pas betejës, mbetën të plagosur të dy fisnikët spanjollë. Më pas u paraqitën dy stradiotë shqiptarë në duel, "armatosur krejt me armë albanoi (sic) dhe me estradiotën në njërën dorë e kapelen në dorën tjetër. Albanoi i Papës i vërvitet tjetrit dhe e dërrmoi në shpatull. Albanoi "francez", kur pa të ndodhë kështu, e mori estradiotën si heshtë dhe ia lëshoi në grykë, duke u lëshutur mbi të me aq fuqi, sa më në fund me goditje topuzi e vrau. "Dhe ishte për të ardhur shumë keq, vijon rrëfimin e tij kronikani, sepse të dy stradiotët vlerësoheshin si shokë fisnikë midis albanojëve"[52];
- Mërkur Bua, kapiten i shquar në ushtrinë franceze, pas një beteje, e sheh veten përballë kushëririt të tij të parë kundërshtar, kapiten në ushtrinë veneciane (në krye të trupave korvate – kroate (!)[53], që ishte zënë rob nga trupat e fisnikut Bajard. Episodi bëhet interesant për faktin se të dy kapitenët kreshnikë shqiptarë kishin qenë në hasmëri të egër me shoshoq në të shkuarën e tyre dhe tashmë ndodheshin përballë njëri-tjetrit, duke ngulmuar secili në krenarinë e tij. Mërkuri i kërkoi të vëllait të tij, dyfish armik, se sikur të ishte ai në vendin e tij, si do të vepronte në këtë rast. Krenar, shqiptari rob i thotë Mërkurit :"Po të kisha në duart e mija, gjithë ari i botës nuk do të të shpëtonte aspak nga urrejtja që kam për ty dhe do të të bëja copa". "- Bukur, ia kthen Mërkur Bua, edhe mua atëherë s'më mbetet tjetër veç të imitoj tërbimin tënd.

---

[49] "Kujtimet e Kalorësit Bayard, i quajtur Kalorësi pa frikë e pa qortesë", Collection Universelle des mémoires, vëll. 15, Paris, Londër, 1786, f. 106-116.

[50] "Mémoires", de Messire Martin du Bellay (historian i kohës), Paris 1835, f. 277.

[51] *Fjalori i Ri historik i rrethimeve e betejave të paharruara,* vëll. 2, Paris 1808, f. 261.

[52] "Mémoires de Robert de la Marc, fisniku I Flëranzhës dhe i Sedanit dhe marshall i Francës, i mbiquajturi Aventurieri i ri" – Collection Universelle des mémoires, Londër, Paris, 1786, vll 16, f. 66-67;

[53] Ngatërresë mëse e zakontë në terminologji nga ana e kronistëve të kohës, ashtu sikurse për stradiotët grekë, që ishin në fakt albanoi.

Dhe para se të ndërhynte fisniku Bajard i prekur nga skena, ai e masakroi duke u dhënë urdhër njerëzve të tij[54];

- Më 1567, "spanjollët kaluan lumin (në rrethinat e Groningut) me not, shoqëruar nga 60 albanoi dhe sulmuan nga pas rebelët, duke vrarë shumë vetë nga francezët". 200 kalorës të lehtë (stradiotë) drejtoheshin nga François Bellemont[55];
- Prill 1581, një kompani shqiptare u masakrua në qytetin francez Kambre;
- Po e mbyllim këtu me një episod të bukur vëllazërimi europian (1587), që na jepet nën penën e shkrimtarit të shqur frëng D'Aubignet, protagonist i ngjarjes. Në Obinje, thotë ai, një e treta e kalorësisë ishte albanoi, dhe këta "tërë kohën ishin me bythë në shalë ([të kuajve]". Albanojët kërkuan të ndesheshin me heshta me 20 fisnikë skocezë (duel). Vetë francezi D'Aubignet ndërhyn për të bërë vëllazërimin midis shqiptarëve e skocezëve dhe të mos bëhej duel me forca të barabarta, ngaqë shqiptarët qenë fyer nga ana e skocezëve (të cilët kishin kërkuar të shkonin në luftë dhe për shqiptarët kishin thënë se s'po ua mbante). Të fyer pra, kapiten Mërkuri kishte kërkuar duel. Me heshta e vetëm me këmishë. "Të dy nunët (drejtuesit e trupave, thotë shkrimtari frëng, i japin më në fund dorën shoshoqit për t'u bërë njësh skocezë-albanoi".[56]

Le të shohim tani konkretisht disa nga familjet e shquara estradiote shqiptare.

Në veprën e tij "E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare", At Zef Valentini duke analizuar 349 fise, bajraqe e vëllazëri mesjetare e moderne, përmend 87 familje që kanë nxjerrë nga gjiri i tyre stradiotë të shquar. Gati gjysma e këtyre familjeve na shfaqen si familje të mëdha e të rëndësishme stradiote. Ndër vllazënitë më në zë të estradiotisë shqiptare, At Valentini përmend familjet Bariçi, Basta, Bërbati, Borshi, Bua, Bushiqi, Dajçi, Grimani, Gjerbesi, Kam(bë)thekra, Kelmendi, Klosi, Kokla, Karpesi, Kuçi, Lëkurësi, Luzi, Manësi, Mazi, Panariti, Plesha (Blessi), Reçi, Rrenci, Skura, Sojmiri, Shpati e Valemi. Këto familje të njohura kanë nxjerrë nga gjiri i tyre përgjithësisht drejtues skuadronesh të stradiotëve shqiptarë, duke qenë se ata na shfaqen në akte dokumentare të kohës për merita apo cilësi ushtarake të tyre.

Po ashtu Mihail Dimitri Strudza, në veprën "Familjet e mëdha të Greqisë, Shqipërisë dhe Konstandinopojës", numëron 15 familje fisnike shqiptare që kanë nxjerrë nga gjiri i tyre historikisht stradiotë të shquar dhe kanë pasur emblemën e tyre, pa përfshirë këtu familjet e mëdha të ishujve të Hidrës e Specias që kanë nxjerrë shumë brezni stradiotësh e armatolësh. Përmend ndër të tjerë familjet Basta, Buskaja, Babica, Koqini, Golemi, Gjenimata, Mavromati, Misura, Muzaka, Bruti (me të shtatë djemtë me tituj fisnikërie).

Aristidh Kola përmend nga ana e tij familjet Bua, Rrepushi, Buzuku, Gërbeshi, Gabriera në ndërtimet venedikase të Kretës, Zakinthit, Qefalonisë dhe Korfuzit[57]. Kurse si kapedanë të mëdhenj stradiotë përmend Mërkur Buan, Manol Bleshin (poet e stradiot që krenohej për prejardhjen e tij arvanitase dhe pohonte se ishte pasardhës i Luan Zguros). Nëpërmjet librit të Bleshit, Aristidh Kola përmend emra arbëreshë, Kasneci, Lopësi, Sqimatari, Mazi, Rabedosha, Kryekuaji, Bishkini, Kalenxiu dhe stradiotin e famshëm Murrik Koklla.

Krahas këtyre familjeve stradiote me emër, mund të përmendim po ashtu edhe kapitenët e shquar Joan Mavromati, Filip Arianiti, Antonio Bruti, Gjergj Dushmani, kapitenin shqiptar Thoma Frata, me gjashtëdhjetë stradiotë në qytetin francez Montarzhi[58], Gjergj Murmurin në krye të 300 stradiotëve albanoi në Kretë, Teodor Bëdenjën me 1500 stradiotë në Teurenë e në Vendet e Ulta, Gjon Kastriotin (i riu) dhe Skënderbeun e Ri në shërbim të Venedikut, që

---

[54] "Kujtimet e kalorësit Bajard", vepër e cituar, vëll. 15, f. 155-157. I njëjti episod përmendet edhe në librin "Les vies des hommes illustres de la France", me autor D'Auvigny, Amsterdam, 1759, vëll. 3, f. 326-328.

[55] "Histoire de Ferdinand Alvarez de Tolede Premier", me emrin Duka i Albës, vëll. 2, Paris, 1649, f.234.

[56] D'Aubignet Th . Agrippa , « Kujtime, botuar sipas dorëshkrimeve të Luvrit", Paris 1854, f. 335-336.

[57] Aristidh P. Kola, "Arvanitasit", vepër e cit., f. 237.

[58] G. Daniel, vepër e cituar. vëll 11 f. 269.

ndoqën veprën e Kastriotit të Madh si kapitenë të shquar stradiotë me kalorësinë e tyre, etj. Përmendim po ashtu garnizonin e shqiptarëve vendosur në Anduzë më 1563-1567[59], kalorësin albanoi Spada[60], stradiotin Mark si shoqërues të një ambasadori,[61] dy kompanitë me kalorës shqiptarë të dukës së Albës në vitin 1567, stradiotët "simariotë" (himariotë) në shërbim të Venedikut gjatë luftrave kundër turkut, kryesisht gjatë mbrojtjes së gjatë të Kretës,[62] mirëditorët në gardën personale të vojvodëve që sundonin në Moldavi e Valaki, të njohur me emrin "garda arnaute",[63] kapiteni Gjergj Mashuka me kompaninë e tij në Leau më 1567-1577[64] etj.

Këta stradiotë të shqar, duke qenë në fund të fundit thjesht në shërbim të luftës, i shohim të jenë fatkeqësisht, herë-herë edhe kundërshtarë me shoshoq, aq sa në betejat kryesore të Italisë në vitet 1494-1549 merrnin pjesë në dy kampet kundërshtare konkretisht :

- Fornovë (1495), 500 kalorës të lehtë stradiotë;
- Cernigola (1503), 4 mijë stradiotë në krahun e francezëve, dhe 1000 kalorës të lehtë në krahun kundërshtar;
- Barleta (1502), 1000 kalorës të lehtë në krahun kundërshtar;
- Carigliano (1503) 500 stradiotë në krahun e francezëve, 8000 stradiotë në krahun kundërshtar;
- Agnaderro (1509), 15000 stradiotë në krahun kundërshtar;
- Ravenë, (1512), 800 stradiotë në krahun francez;
- Novara (1513), 4000 stradiotë në krahun francez;
- Marinjan (1515), 500 kalorës të lehtë në krahun francez;
- po kështu në Pavi (1525), në Ceresole d'Alba (1544), e me radhë.

Krejt ndryshe nga autorët e sipërpërmendur, që flasin për stradiotët albanoi dhe bëmat e tyre në shesh të betejës, Edwin Jacques, në veprën e tij "Shqiptarët" e përmend shqiptarin jo më thjesht stradiot, por edhe njeri të artit, kulturës, letrave. Konkretisht :

Më 1378, në Republikën e Gjenovas mërgoi familja tregtare shqiptare "Durazzo" që brenda një shekulli u bë nga më të pasurat në rajon. Dozhi apo presidenti i parë i Republikës ishte Xhakomo Durazzo dhe gjashtë presidentë e dy kardinalë mbajnë mbiemra që dëshmojnë për origjinën e tyre shqiptare.

Më 1479, me rënien e Shkodrës, tre vëllezërit Gazuli shkuan në Venedik me garnizonin e tyre (Andrea, Gjoni dhe Pali), që dhanë ndihmesë të madhe në fushën diplomatike e politike. Gjoni u shqua për astronomi.

Refugjatëve të kësaj shpërnguljeje, iu dhanë toka në afërsi të Venecies (Friuli në lindje) që u ndanë në 150 pjesë, domethënë në 150 familje. Në fakt, turqit kishin depërtuar gjer në atë krahinë. "Venedikasit duke njohur turqit, thotë studjuesi Edwin Jacques (dhe vlerën e shqiptarëve do shtonim ne nga ana jonë), është fare e natyrshme të dyshohet se themelimi i një kolonie refugjatësh shqiptarë si mburojë, në të vërtetë nuk ishte aq altruist sa dukej"[65]. Megjithatë, shumë nga të sapoardhurit atje fituan famë. Autori përmend Marin Barletin për emrin që krijoi me dy veprat e tij; Leonik Tomeun (1497), që jepte filozofi në Universitetin e Padovas (ndër nxënësit e tij pati Kopernikun); Marin Beçikemi që shkroi komentarë për Ciceronin, Plinin etj., familjen Albani, Papa Klementin XI, Aleksandër Albanin me kryeveprat e artit modern e antik, Francesko Albanin, piktorin e talentuar, skulptorin dhe arkitektin Andrea Aleksi, etj.

---

[59] J.P. Hugues, "Histoire de l'Eglise reformée d'Andouse", Paris 1864.
[60] P. Boitel, "Les tragiques accidents des hommes illustres et des personnes signalées de l'Univers", Paris, 1614, f. 801.
[61] "Mémoires du marquis d'Argens", shambellan i Frederikut të Madh, mbretit të Prusisë, Paris 1807, f. 369-370.
[62] M.D. Strudza, vep. e cituar, f.83.
[63] Po aty.
[64] "Commentaires de Bernadino de Mendoça, sur les événements de la guerre des Pays-Bas" vëll. 2, Bruksel, Hagë, 1858, f. 398-402.
[65] Edwin Jacques, vepër e cituar, f. 222-223.

Autori arrin në përfundimin se në pjesën më të madhe, këta mërgimtarë përfaqësonin elitën e kombit shqiptar, udhëheqjen e tij. Ata dhanë kështu ndihmesën e tyre për zhvillimin e kulturës së vendeve të tjera, krahas gjakut që derdhnin si stradiotë në krejt vendet e Europës.

Në përfundim, le të shohim përmbledhtas dy figura madhore stradiote shqiptare : Mërkur Buan dhe Gjergj Bastën, njëri në fillim të lulëzimit të estradiotisë shqiptare, tjetri në mbarim të këtij lulëzimi, kurorëzuar me lavdi :

Mërkur Bua (? –1560), u vu fillimisht në shërbim të venedikasve me 100 trupat e veta albanoi nën komandën e Markezit të Mantusë (Fransua dë Gonzag), komandanti kryesor i ushtrisë veneciane. U përpoq të organizonte kryengritjen e përgjithshme në More e që këtej në Shqipëri, duke i kërkuar, thotë studiuesi Aristidh Kola, mbështetje simbolike me trupa krye-gjeneralit të forcave venedikase Françesko della Roveres. Si aleat i ngushtë i markezit dhe më pas dukës së Mantusë, kaloi në shërbim të francezëve (1502), kur Luigji XII u bë sundimtar i Lombardisë, dhe u shërbeu atyre deri në fund me besnikëri. At Danieli thotë për të se ishte në krye të 2000 trupave stradiote (nga të cilat 1200 albanoi), që përbënë zanafillën e kalorësisë së lehtë franceze të krijuar nga Luigji XII. U shqua në të gjitha betejat si kapiten i madh i kohës, duke filluar që nga betejat e Fornovës (1495), Lomdardisë (1497), të Barletës dhe Gjenovas më 1507 e me radhë gjatë tërë luftërave në Itali. I ngarkoheshin misione të vështira, të cilat i realizonte me sukses e me shpejtësi. Kishte aftësi të shkëlqyera drejtuese dhe organizative. Studjonte, thotë Kola, betejat e Skënderbeut dhe ndiqte strategjinë dhe taktikat e tij. Kronikasi Jean d'Auton skicon portretin e tij, duke e cilësuar "fisniku Mërkur" ; kalorës shqiptar, burrë i fortë dhe shumë i zoti, sipas mënyrës së vendit të tyre, kishte me vete 100 shqiptarë, të gjithë njerëz të zgjedhur për zanat të luftës." Me këtë rast, po ky autor thotë se në rrethinat e Romës, tre milje larg saj, ishte një abaci, ku mesha këndohej në greqisht dhe se stradiotët albanoi shkonin aty për të takuar familjarët e tyre[66]. Po ashtu, Irakli Koçollari na jep edhe ai të dhëna konkrete për të, si i ardhur nga Nafplio e Peloponezit, stërnip i Mërkur Bua Zguros, dhe nip i Petro Buas, komandantit të forcave kryengritëse arvanite në Peloponez kundër osmanëve. I mahnitur nga veprimet luftarake të Mërkur Buas në beteja të shumta, mbreti Luigji XII i jep atij titullin e kontit dhe gradën e gjeneralit, duke e bërë gjithashtu komandant të kalorësisë së lehtë që në atë kohë përbëhej nga 6000 trupa.[67] Koçollari paraqet po ashtu edhe stemën e familjes së Mërkur Buas, ku veç simboleve të derës së Buajve, bien në sy edhe simbole e flamuj mbretërorë që Mërkuri i fitoi me shërbimet e tij të mëdha gjatë betejave të shumta të kurorëzuara me sukses.

Një tjetër kapiten Mërkuri shfaqet po ashtu në literaturën historike franceze të kohës (ndoshta nip i Mërkur Buas apo pinjoll i kësaj familjeje) gjatë viteve 1580 dhe shkëlqen gjatë betejës së famshme të Kutras në regjimentin e Lavardinit që i shërbente dukës Dë Zhuajëz (De Joyeuse) në luftrat civile të Francës. Ky kapiten stradiot albanoi që shkëlqen nga fundi i estradiotisë shqiptare përmendet në disa Memuare dhe në "Fjalorin e betejave të paharruara" dhe dëshmon për vijimësinë dhe emrin e mirë të kalorësisë së lehtë shqiptare në Francë dhe në Europën Perëndimore.

Gjergj (Georges) Basta (1544? 1550-1607), gjeneral i famshëm me origjinë shqiptare, që pati një jetë të regjur luftarake, duke qenë se kaloi tërë jetën në luftra, praktikisht pa ndërprerje. Rridhte nga një familje me traditë të pasur ushtarake, duke qenë se edhe i ati, Dhimitër Basta, kishte qenë oficer karriere në shërbim të Karlit V dhe vdiq me gradën e kapitenit. Gjyshi i tij, Andrea Basta, bashkëluftëtar i Skënderbeut, ishte nga fshati Bastje, afër Butrintit të Sarandës. Familja Basta është familje stradiote nga më të lashtat shqiptare, që përmendet që në shekujt XI-XII. Në shekullin XIV, Bastat mërgojnë fillimisht në shtetet e mbretit të Napolit, më pas, në veri të Europës, nga ku zbresin sot shumë familje të fisnikërisë së Belgjikës.

Fillimisht Basta mori pjesë në shumë fushata në Flandër e në Francë. Komandoi një regjiment kalorësie shqiptare, kur duka i Parmës mori në zotërim qeverisjen e Vendeve të

[66] L. Jacob, "Chronique de Jean d'Auton", sipas dorëshkrimeve të bibliotekës së mbretit, vëll.3 Paris 1835, f. 12-39.
[67] I. Koçollari, vep. e cituar, f. 135.

Ulta më 1579. Duke i njohur shpejt meritën Gjergj Bastës, duka e bëri atë Komisar të përgjithshëm të kalorësisë më 1580 (një risi për Vendet e Ulta në atë kohë). Ishte pikërisht duka i Albës që e kishte çuar aty që më 1567. Mbante trupën e tij nën një disiplinë të fortë dhe në të tëra luftimet luante rol kryesor.

Betejat kryesore :

1584, rrethimi i Anversës

1588, rrethimi i Bonit;

1590, i shkoi në ndihmë Lidhjes së shteteve në Francë;

1592, komandoi prapavijën e Lidhjes gjatë tërheqjes;

1593, i shkoi në ndihmë kontit Charles de Mansfeld, Francë;

1593, fushata në Hungari;

1596, rikthehet në Vendet e Ulta, ku kryen detyra të vështira;

Teatri më i bukur i bëmave të tij është padyshim Hungaria e Transilvania;

1598, arqiduka Maksimilian dhe Gjergj Basta caktohen të marrin nën zotërim Transilvaninë, në emër të perandorit austriak Rudolf II; Basta emërohet nga perandori lietnant gjeneral për Transilvaninë[68] dhe administrator perandorak i kontesë së Maramurit.

1599, i dha urdhër të prerë Mikelit të Valakisë të shpërngulej nga principata dhe duke qenë se ky nuk e pranoi këtë kërkesë, e sulmoi në Miriszlo dhe e mundi plotësisht. Më pas, me urdhër të perandorit u pajtua me vojvodin Mikel, ndaj të cilit ushqente urrejtje hakmarrëse;

1600, fitore e plotë në Transilvani;

1601, fitore e shkëlqyer kundër Bathorit, princ i Transilvanisë (që kishte 40 mijë trupa, turq, tatarë e kozakë); marrja e Klaussemburgut, urdhri i dhënë nga ai për vrasjen e voivodit të Valakisë, princit Mikel (Mihail) Trimit, të cilin e akuzoi për lidhje të fshehta me turqit[69];

1601, thirret të komandojë ushtrinë perandorake në Hungari; ndodhet i rrethuar në krye të 14 mijë trupave perandorake nga kryengritësit heidukë në mes të dimrit, në një grykë të ngushtë. Ushtarët e tij janë të lodhur, të demoralizuar, pa ushqime. Basta shfaq aftësitë e veta si strateg ushtarak; i qetë, i paepur, merr masa vigjilence, siguron njerëzit, u ngre moralin, bën planin e çarjes së rrethimit në mes të natës. Mbledh kolonelët, asgjëson e djeg krejt bagazhin e rëndë, i lehtëson ushtarët nga pesha e armatimit dhe shpërthen rrethimin duke zënë lartësitë me shpejtësi e në heshtje të plotë, në mes të natës. Shpërthen sulmin dhe arrin fitore, duke humbur vetëm 200 vetë, ndërkohë që kryengritësit humbasin 12 mijë vetë. Basta sheh në këtë fitore të veçantë, në kulmin e dëshpërimit të ushtrisë, dorën e Perëndisë.[70]

1603, në krye të ushtrisë perandorake ndodhet në Transilvani përballë trupave të vezirit turk Ali Pasha me 60 mijë vetë në qytetin Pesth. Qëndresë e Bastës, që përdor me mjeshtëri

[68] « Duke dashur të fusë kundër-reformën në Transilvani, [Basta] ngriti kundër vetes krejt popullatën e këtij shteti", thekson M.D. Strudza në veprën e tij "Grandes familles de Grèce, d'Albanie..." f.109.

[69] Nicolae Jorga në veprën e tij "Histoire des Roumains et de leur civilisation" shprehet me këtë rast: "I mërituri shqiptar Gjergj Basta, ky kardinal, ndaj të cilit ai [Mikel Trimi] ishte i shtrënguar t'i njihte kryezotësinë, po aq të padobishme sa dhe poshtëruese".

[70] Konti De Villermont, "Tilly ou la guerre de trente ans (1618-1632)", vëll. 1, Paris, 1860, f. 33-46.

artilerinë e fuqishme perandorake dhe fushimin në transhe. "Sa herë që perandori ndodhej në vështirësi, thotë konti i Villermontit, kërkonte detyrimisht praninë e Bastës me trupat e tij"[71]

1603-1604, marrja e Bistricës në Sikula, teatri i luftimeve vazhdon në Transilvani, e më pas në Hungari, ku ushtron dhunë të fortë. Humbje e betejës nga ana e tij në krye të trupave perandorake përballë Etienne Bostkait;

1604, komanda e lartë e ushtrisë nën arqidukën Mathias iu besua Gj. Bastës.

1605, trupat e tij në Komorrë u bënë pengesë e pakapërcyeshme për turqit. Ka qenë nderuar me titullin kont dhe thuhet për të se asnjëherë turqit nuk patën epërsi ndaj tij.[72]

Pas disa dështimesh në Transilvani, Basta u tërhoq nga jeta publike dhe iu përkushtua hartimit të traktateve të strategjisë ushtarake. Me veprën e tij "Mbi qeverisjen e kalorësisë së lehtë" (1612) firmos një nga traktatet më të rëndësishme të historisë kalorësiake, sepse është i pari që u orvat të trupëzojë e të doktrinojë këtë formacion ushtarak. Një tjetër vepër që i njihet Bastës është vepra "Mbi detyrat e shtatmadhorisë" (1606) vepra e tij e parë. Iu dha nga perandori titulli Kont i Perandorisë së Shenjtë dhe i Hustit dhe arriti gradën e gjeneralisimit. Emblema e tij përfaqësohet nga një shqiponjë e zezë dykrenore dhe në të dy anët diametralisht, kalorës mbi kalë me shpatë në dorë që simbolizojnë bukur estradiotinë shqiptare të dy shekujve lulëzimi dhe që kurorëzohen prej kësaj figure madhore ushtarake të kohës.

Nikolla Basta, i vëllai i tij, shfaqet po ashtu me gradë të lartë dhe ushtarak me emër në shërbim të Spanjës në Vendet e Ulta, ku e kishte marrë duka i Albës më 1567. U shqua në disa beteja, si në disfatën e Nuesë.

Në përfundim, mund të themi se periudha e lulëzimit të estradiotisë shqiptare, para, pas dhe gjatë periudhës skënderbejane – kurorëzuar, njëfarësoj, nga albanuaja e shquar, kapelja e lartë shqiptare e Mesjetës, mbajtur mbi krye edhe nga vetë mbreti i Francës, ashtu si edhe kapuçi tjetër albanua -, është një kontribut me vlerë i popullit shqiptar në rrafsh europian, që bëri të mundur me qëndresën e tij prej një çerek shekulli kundër perandorisë osmane dhe me kontributin e gjakut stradiot shqiptar përgjatë dy shekujsh, "lulëzimin e Rilindjes eurapiane, reformimin, eksplorimin e botës perëndimore, ku do të strehoheshin qindra e mijëra pasardhës të tij [të Skënderbeut]".[73] Na pëlqen ta përfundojmë këtu me fjalët e të madhit Çabej, 100 vjetorin e lindjes të të cilit po e festojmë këtë vit se "Si në kohën antike, ashtu dhe më vonë, ky popull malësor i fortë jep gjakun e tij për mbrujtjen e kombeve të reja ballkanike, jo vetëm me anë të përzjerjes etnike, por edhe në pikëpamje politike, si kasta luftëtare e Ballkanit, me armë në dorë".[74] Dhe më tej, si kasta luftëtare e mbarë Europës me estradiotinë e shquar shqiptare!

---

[71] Po aty.

[72] Pierre Bayle "Dictionnaire critique et historique", vëll. 3, Paris 1820, f. 162-165; "Histoire de l'Empire d'Autriche en six époques" nga Kalorësi Charles de Coeckelberghe de Dutzele, vëll. 5, Viene, 1845, f. 287-302.

[73] Edwin Jacques, vep. e cituar. 213.

[74] E. Çabej, vep. e cituar, f. 17.